



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.165 dt.06.11.1998

**MBI SHQYRTIMIN E ANKESAVE PER DHENIE TE LEJEVE
TE NDERTIMIT NGA K.RR.T.**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.06.11.1998, pasi shqyrtoi ankesat e disa qytetarëve, disa prej të cilave të përcjella nga Prefektura e Tiranës, duke u mbështetur në ligjin Nr.7572, dt.10.06.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e Pushtetit Lokal”, si dhe në ligjin Nr.8015, dt.19.10.1995, neni.12, “Për disa ndryshime” në ligjin Nr.7693, dt.26.04.1993 “Për urbanistikën” dhe pasi dëgjuan propozimin e Komisionit të Zhvillimit Urban dhe Ndërtimeve;

V E N D O S I

1. a) Shkresa me Nr.973/2, dt.25.06.1998 nga Prefektura, lidhur me ankesën për ndërtimin e kryer nga R.Jashari, në njërën nga pasazhet në bllokun e pll. Nr.204 në Rr.”Durrësit”(leje për lokal).

Këshilli Bashkiak miraton propozimin e Komisionit të Zhvillimit Urban dhe Ndërtimeve, se kalimi nuk është i bllokuar, sepse është një pasazh anësor.

- b) Lidhur me lejen e ndërtimit dhënë nga K.RR.T. për Z.Artan Trebicka.

Këshilli Bashkiak miraton propozimin e Komisionit të Zhvillimit Urban dhe Ndërtimeve, që leja e dhënë nga K.RR.T.

për Z.Artan Trebicka është e rregullt. Disa ndryshime pa leje kanë krijuar kushte të reja të cilat nuk mund të merren parasysh.

2. Shkresa me Nr.1425, dt.17.08.1998 nga Prefektura dhe peticioni nga banorët e lagjes Nr.6 Kombinat, se leja e dhënë për ndërtim në Rr.”Ali Kelmendi” i përket një trualli që është lulishte.
Këshilli Bashkiak miraton propozimin e Komisionit të Zhvillimit Urban dhe Ndërtimeve që trualli i dhënë për ndërtim nuk është lulishte sepse ky tuall nuk figuron si lulishte në ndërmarrjen e specializuar për këtë qëllim.
3. Familja Beja kërkon pezullimin dhe anulimin e lejes së ndërtimit dhënë në vendimin Nr.394, dt.09.09.1997 të K.RR.T. Këshilli Bashkiak miraton propozimin e Komisionit të Zhvillimit Urban dhe të Ndërtimeve, se problemet e pronësisë nuk janë kompetencat e Këshillit Bashkiak.
4. Një grup qytetarësh lidhur me lejen e ndërtimit në Rr.”M.Grameno” pretendojnë se ky truall është lulishte. Këshilli Bashkiak miraton propozimin e Komisionit të Zhvillimit Urban dhe Ndërtimit se ka vend për shqyrtimin në K.RR.T.
5. Familja Dizdari ankohet për firmën ndërtuese “Ersi” për shkelje të kushteve urbanistike.
Këshilli Bashkiak miraton propozimin e Komisionit të Zhvillimit Urban dhe Ndërtimit se nuk rezulton të jetë e saktë.
6. Ankesa e familjes Ashta për mos respektimin e distancës 50 cm të ndërtimit të ri nga ekzekutesi është i drejtë siç u verifikua në vend për këtë dhe konstatime të tjera të këtij lloji si ngritja e katit më shumë se leja e dhënë, çështja duhet t’i referohet policisë ndërtimore, ndërsa problemet e pronësisë nuk i takojnë Këshillit Bashkiak.
7. Z.Muharrem Nelku banor në Rr.”Thanas Ziko”, pll.6/1 (është me qera) Tiranë kërkon ti jepet leje ndërtimi për ndërtim 3 katësh në truall të blerë.

Këshilli Bashkiak miraton propozimin e Komisionit të Zhvillimit Urban dhe Ndërtimi se kërkesa e tij nuk miratohet, sepse shkelet vija e ndërtimit, prandaj mbetemi në miratimin e ndërtimit të një kioske.

8. Z.Skënder Maja banues në Rr.”Pandi Dardha”, pll.41, ap.5, Laprakë ankohet për probleme pronësie.

Këshilli Bashkiak miraton propozimin e Komisionit të Zhvillimit Urban dhe Ndërtimi se problemi i pronësisë nuk i takojnë Këshillit Bashkiak.

9. Banorët e pallateve Nr.25, 27, 29 në Rr.”Muhamet Gjollesha” ankohen për lejen e ndërtimit për familjen Dobi e Hodo të një ndërtese 10 katëshe.

Këshilli Bashkiak miraton propozimin e Komisionit të Zhvillimit Urban dhe Ndërtimi se leja e ndërtimit është dhënë në përputhje me kushtet urbanistike.

- 10.Z.Skënder Qefalia banues në Rr.”Shinasi Dishnica” Nr.98 ankohet për çështje pronësie.

Këshilli Bashkiak miraton propozimin e Komisionit të Zhvillimit Urban dhe Ndërtimi se për çështje pronësie është në shqyrtim gjygjësor, prandaj nuk i takon Këshillit Bashkiak.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI